



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-207874  
Më 1.12.2015


Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat nr. 04/L-045, dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e fillimit të procedurave ligjore për procedimin e projekteve me Partneritet Publiko Privat për varrezat e reja në Landovicë, kryetari i Komunës, më 1 dhjetor 2015, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e fillimit (zhvillimit) të procedurave ligjore për procedimin e projekteve me Partneritet Publiko Privat për varrezat e reja në Landovicë, kështu që, për këtë qëllim dhe duke u bazuar në Ligjin për Partneritet Publiko Privat nr. 04/L-045, në Direktivën nr. 1/2011 mbi procedurat për shqyrtimin dhe aprovimin e projekteve me PPP dhe Direktivën nr. 3/2011 për shqyrtimin dhe miratimin e projekteve komunale, Komuna e Prizrenit, lejon fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e varrezave të reja në Landovicë me Partneritet Publiko Privat (PPP).
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike.
3. Me këtë Vendimi të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Organet Kompetente sipas ligjit si dhe Arkivi.
4. Ky Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-207877  
Më 1.12.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Partneritet Publiko-Privat nr. 04/L-045, të Direktivës nr. 2/2011 për formimin e ekipeve për menaxhimin e projekteve, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejin e formimit të ekipit për menaxhimin e projektit me Partneritet Publiko Privat për varrezat e reja në Landovicë, kryetari i Komunës, me 1 dhjetor 2015, miratoi këtë:

#### A K T V E N D I M

1. Formohet dhe emërohet Ekipi për menaxhimin e projektit me Partneritet Publiko Privat për varrezat e reja në Landovicë. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
  - 1.1. Fejsal Hoti, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike,
  - 1.2. Hatixhe Përzhella, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike,
  - 1.3. Afërdita Mormorina, nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
  - 1.4. Isa Osmankaj, nga Sektori i Prokurimit,
  - 1.5. Sefer Avduti, nga Sektori i Pronës.
2. Detyrat e Ekipit nga pika I e këtij Aktvendimi janë të parapara në Ligjin për Partneritet Publiko-Privat nr. 04/L-045 dhe Direktivës nr. 2/2011 për formimin e ekipeve për menaxhimin e projekteve.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimt të këtij Aktvendimi.
4. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, si dhe të emëruarit.
5. Me këtë Aktvendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, të emëruarit, Organet Kompetente sipas ligjit si dhe Arkivi.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti




Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-207880  
Më 1.12.2015

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204, të Ligjit mbi faljen e borxheve dhe Udhëzimit Administrativ nr. 04/2015 për procedurat e faljeve të borxheve si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, kryetari i Komunës, më 1 dhjetor 2015 miratoi këtë:

#### A K T V E N D I M

1. Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave rreth kontestimit të borxhit nga tatimi në pronë dhe taksat tjera komunale, i bazuar sipas Ligjit për faljen e borxheve, për vitin 2015 dhe 2016 dhe për shqyrtimin e ankesave nga tatimi në pronën e paluajtshme në Komunën e Prizrenit për vitin 2016. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
  - 1.1. Islam Osmankaj, kryesues,
  - 1.2. Shpend Berisha, dhe
  - 1.3. Abdulla Smaili, anëtar.
2. Detyrat e Komisioni nga pika I e këtij Aktvendimi janë të parapara në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204, në Ligjit mbi faljen e borxheve dhe në Udhëzimit Administrativ nr. 04/2015 për procedurat e faljeve të borxheve.
3. Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi.
4. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa si dhe të emëruarit.
5. Me këtë Aktvendim, të njoftohen: Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, të emëruarit, Departamenti i Tatimit në Pronë si dhe Arkivi.
6. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti


Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-207883  
Më 1.12.2015

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 20 pacientëve, kryetari i Komunës, më 1 dhjetor 2015, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Fadile Mazreku, 2. Ajla Gota, 3. Hatixhe Vezaj, 4. Emsal Limani, 5. Bora Morina, 6. Shpresa Shala, 7. Myzafere Krasniqi, 8. Nyrisha Ademaj, 9. Arifka Oskaçak, 10. Shefket Gajraku, 11. Tixhë Hoxha, 12. Femije Bekteshi, 13. Nybyvet Recepoglu, 14. Zehra Koro, 15. Nasibe Salihi, 16. Kadri Gashi, 17. Bajram Brahaj, 18. Gjansell Bytyqi, 19. Peran Hasi, dhe 20. Albulena Berisha.
2. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në vlerë prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja





Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-205478  
Më 1.12.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e shpalljes së tenderit për renovimin emergjent të kulmeve të dëmtuara në tri objektet shkollore të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë:

#### K O N K L U Z I O N

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për lejimin e renovimit emergjent të kulmeve të dëmtuara në tri objektet shkollore të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse për renovim të kulmeve të dëmtuara të:
  - 1.1. ShFMU “Pjetër Budi” në Luginë të Hasit dhe paralelja e ndarë në Dedaj dhe
  - 1.2. ShFMU “Luigj Gurakuqi” në Nashec.
2. Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
3. Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.
4. Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/06-205478  
Më 1.12.2015

Kryetari i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2015 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e shpalljes së tenderit për organizimin e një punëtorie treditore lidhur me hartimin e Strategjisë Komunale për Komunitete dhe Kthim për periudhën 2016-2020, dhe mori këtë:

#### K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e organizimit të një punëtorie treditore lidhur me hartimin e Strategjisë Komunale për Komunitete dhe Kthim për periudhën 2016-2020, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Mjetet financiare për këtë qëllim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave dhe shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**

Kryetari i Komunës  
Nr. 01/011-207886  
Më 1.12.2015



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Sabina Birdaini-Dana, nënkryetare e Komunës për Komunitete, kryetari i Komunës, më 1 dhjetor 2015, miratoi këtë:

#### V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Sabina Birdaini-Dana, nënkryetare e Komunës për Komunitete, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë, me temën: “Mundësitë e financimit të partnerëve të projektit PROSPEKT dhe projekteve tjera nga fondet publike” e cila organizohet nga KFOS-i dhe është në kuadër të projektit “Promovimi i integritit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë”. Punëtorja (takimi) do të mbahet nga data 4 dhjetor deri me 7 dhjetor 2015, kështu që, për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurën.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës  
Prof. dr. Ramadan Muja